

Kuptimi i shqyrtimit të individualizuar për procesin e zgjedhjes së shkollës

Prezantim

Shqyrtimi i individualizuar është një proces që zgjerohet mbi atë që më parë njihet si shqyrtimi i paanshëm LeGare. Shqyrtimi i individualizuar kryhet kur një nxënës aplikon në nivelin e klasës hyrëse të një programi të shkollës pasfillore ose të mesme me bazë kriteresh. Ky proces u mundëson nxënësve të caktuar të kualifikuar mundësinë të tërhiqen nga një (1) kriter në mënyrë që ekipi i shqyrtimit të individualizuar të përcaktojë përshtatshmërinë për shkollat në bazë të kriterëve. Shqyrtimi i individualizuar është procesi i apelimit për nxënësit që nuk plotësojnë një kërkesë pranimi për të përcaktuar nëse çdo shkollë me bazë kriteresh që nxënësi kërkon të ndjekë mund të ofrojë në mënyrë të arsyeshme mbështetjen e duhur. Udhëzimet dhe informacionet shtesë mund të gjenden në [faqen](#) e [shqyrtimit](#) të [individualizuar](#) të faqes së internetit të zgjedhjes së shkollës.

Kush mund të kualifikohet për një shqyrtim të individualizuar

Nxënësit mund të marrin një shqyrtim të individualizuar nëse aplikojnë në një shkollë me bazë kriteresh në nivelin e klasës hyrëse dhe janë në një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme:

- Kanë një paaftësi që ka IEP aktuale ose
- Kanë një plan aktual 504 ose kualifikohen për 504, ose
- Janë duke ndjekur shërbime për mësimin e gjuhës angleze (EL).

Nxënësit që bëjnë pjesë në këtë kategori dhe zgjedhin të tërhiqen nga një (1) kriter i shënuar në aplikimin e tyre, mund të marrin një shqyrtim të individualizuar për të përcaktuar nëse duhet të futen apo jo në shortin e asaj shkolle. Aplikantët duhet të plotësojnë dy (2) kritere për shkollat në të cilat aplikojnë në mënyrë që të kualifikohen për shqyrtim të individualizuar. Përveç zgjedhjes së një kriteri për të hequr dorë, aplikanti duhet të paraqesë gjithashtu një [shtojçë të plotë të pranimeve](#) dhe dokumentacionin mbështetës. Këto dokumente kërkohen brenda aplikimit SchoolMint. Aplikantët që nuk i përfshijnë këto dokumente nuk do të marrin shqyrtim të individualizuar.

Procesi i shqyrtimit të individualizuar nuk garanton pranimin në shortin e një shkolle ose programi dhe nuk garanton se një nxënës që heq dorë nga një kriter do të pranohet në një shkollë apo program me bazë kriteresh.

Pse një aplikant mund të mos kualifikohet për një shqyrtim të individualizuar

Disa nxënës me një plan/kualifikim aktual IEP, 504 ose shërbime EL mund të aplikojnë në një shkollë ose program me bazë kriteresh në nivelin e klasës hyrëse dhe ende nuk janë të kualifikuar për një shqyrtim të individualizuar. Arsyet që një nxënës mund të mos marrë një shqyrtim të individualizuar përfshijnë:

- Nxënësi aplikon vetëm në shkollat përmbledhëse ose në të gjithë qytetin.
- Nxënësi nuk ka kërkuar të tërhiqet nga një nga kriteret.
- Nxënësi është tërhequr nga kriteret e gabuara (për shembull, nuk plotëson kriteret e frekuentimit për një shkollë, por ka treguar në aplikim se ka dashur të tërhiqet nga vlerësimet e standardizuara).
- Nxënësi nuk ka dorëzuar dokumentacionin mbështetës (duke përfshirë [shtojçën](#) e [pranimeve](#)).
- Nxënësi duhet të tërhiqet nga më shumë se një kriter kualifikimi.
 - Nxënësit duhet të plotësojnë dy nga tri kriteret për shkollat me bazë kriteresh që zgjedhin në mënyrë që të kualifikohen për një shqyrtim të individualizuar.
- Nxënësi ka të drejtë për të paktën një shkollë me bazë kriteresh në të cilën ka aplikuar.
 - Nëse ndonjë aplikant ka të drejtë për ÇDO shkollë me bazë kriteresh për të cilën ka aplikuar, ai nuk do të marrë një shqyrtim të individualizuar për shkollat e mbetura ku ka aplikuar pa plotësuar kriteret.

Afati i shqyrtimit të individualizuar

15 shtator në orën 16:00 – 27 tetor në orën 23:59

- Nxënësit e kualifikuar duhet të paraqesin një aplikim për zgjedhjen e shkollës dhe brenda aplikimit të përcaktojnë statusin si nxënës me një IEP, plan/kualifikim aktual 504 ose shërbime EL dhe të identifikojnë kriteret nga të cilat dëshirojnë të tërhiqen, drejtpërdrejt brenda aplikimit.
 - Familjet duhet të punojnë ngushtë me konsulentin e nxënësve për të kuptuar se cilat kritere janë të përshtatshme për tërheqje dhe për të kuptuar se cilat shkolla/programme përputhen me pikat e forta dhe interesat e nxënësit të tyre. [Lista e kontrollit](#) e [shqyrtimit](#) të [individualizuar](#) ofron udhëzime se si të bashkëpunohet në mënyrë efikase me stafin e shkollës për nxënësit që marrin pjesë në shqyrtimin e individualizuar

Nëntor 2023

- Familjet do të marrin një përditësim në lidhje me statusin e kualifikimit të nxënësve të tyre për të gjitha shkollat/programet ku kanë aplikuar. **Aplikimet që do të shqyrtohen nga ekipi i shqyrtimit të individualizuar do të kenë statusin e *shqyrtimit të kriterëve shtesë në pritje*.**
 - *Vini re se ky status përdoret gjithashtu për nxënësit që kanë aplikuar në një shkollë ose program të bazuar në performancë ose projekt dhe kanë përmbushur kriteret akademike, dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në komponentin e*

performancës ose prezantimit të projektit të kriterëve të një shkolle. Nuk është vetëm për nxënësit e shqyrtimit të individualizuar.

- Ekipi i shqyrtimit të individualizuar do të fillojë shqyrtimin e aplikimeve për të përcaktuar nëse aplikanti duhet të konsiderohet i kualifikuar për shortin e një shkolle ose programi.

Dhjetor 2023

- Ekipi i shqyrtimit të individualizuar do të vazhdojë të shqyrtojë aplikimet për të përcaktuar nëse aplikimi duhet të konsiderohet i përshtatshëm për shortin e një shkolle ose programi.

Janar 2024

- Ekipi i shqyrtimit të individualizuar do të përfundojë shqyrtimet e aplikimeve të kualifikuara.
- Familjet do të marrin komunikim në lidhje me statusin e pranimit të shortit të nxënësit të tyre bazuar në vendimin e marrë nga ekipi i shqyrtimit të individualizuar.
- Nxënësit që rezultojnë të kualifikuar për një short me bazë kriteresh të shkollës ose programit sipas vendimit të ekipit të shqyrtimit të individualizuar do të futen në shortin për atë shkollë/program.
- Rezultatet e shortit do t'u komunikohen nxënësve/familjeve.

Si të nisni një shqyrtim të individualizuar

Nxënësit e kualifikuar përdorin aplikimin e zgjedhjes së shkollës për të nisur procesin. Seksioni i **akomodimeve arsimore** të aplikimit është vendi ku aplikantët tregojnë statusin e tyre IEP, 504 ose EL dhe identifikojnë kriteret nga të cilat dëshirojnë të tërhiqen. **Bazuar në përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve të përfshira në këtë seksion, seksione shtesë i shtohen aplikimit të një nxënësi në mënyrë që familjet të mund të ofrojnë dokumentacionin e kërkuar mbështetës.**

Udhëzimet për mënyrën e plotësimit të këtyre pjesëve specifike të aplikimit janë përfshirë më poshtë.

Seksioni i akomodimeve arsimore

Nxënësve të regjistruar aktualisht në klasat 4, 5, 6 ose 8 u kërkohet të tregojnë nëse janë ose jo nxënës me IEP aktuale, plan/kualifikim aktual 504 ose duke marrë aktualisht shërbime EL. Nëse kanë IEP, do t'u kërkohet të identifikojnë llojin paaftësisë parësore. **Për nxënësit aktualë të qarkut, përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve do të plotësohen automatikisht brenda aplikimit.** Imazhi në anën e djathtë të ekranit tregon se si duken këto pyetje brenda aplikimit.

The screenshot shows a form with three questions, each with radio button options for 'Yes' and 'No'. The first question is 'Does this student have a current IEP? (Yes / No) *' with 'Yes' selected. Below it is a dropdown menu for 'Primary Disability Type'. The second question is 'Does this student have a current 504? (Yes / No) *' with 'Yes' selected. The third question is 'Does this student currently receive EL services? (Yes/No) *' with 'Yes' selected.

Është gjithashtu dhe çështja e tërheqjes, ku aplikantët mund të zgjedhin të tërhiqen nga rezultatet e Frekuentimit, Notave, **OSE PSSA/Vlerësimi** alternativ në aplikimin e tyre. **Ata mund të zgjedhin vetëm një nga këto opsione.** Ata gjithashtu mund të zgjedhin të mos tërhiqen nga asgjë ose të tregojnë se janë nxënës që nuk ka IEP, plan/kualifikim 504 apo shërbime EL. **Aplikantët e interesuar për të marrë pjesë në një shqyrtim të individualizuar duhet të zgjedhin kriteret e dhura për tërheqjen, bazuar në të dhënat e tyre akademike dhe se si të dhënat e tyre akademike krahasohen me kriteret e deklaruara për shkollat ku po aplikojnë.**

The screenshot shows a text box with the following text: 'If you replied "Yes" to any of the above questions, you may waive Attendance, Grades or PSSA/Alternative Assessment criteria in your student's application. If your student has a 504 plan, IEP, or is an English Learner and you do not waive a criteria, your student will not be given an individualized review. *'. Below the text are five radio button options: 'Attendance', 'Grades' (selected), 'PSSA/Alternative Assessment Scores', 'I do not want to waive any criteria', and 'I do not have an IEP/504/EL designation'.

Do të shfaqet gjithashtu një fushë nënshkrimi në të cilën një prind/kujdestar duhet të aplikojë nënshkrimin e tij elektronik. Pas futjes së nënshkrimit elektronik, përdoruesit mund të klikojnë **Save & Continue** (Ruaj e vazhdo) në fund të ekranit për të vazhduar në seksionin tjetër të aplikimit të tyre.

I understand that by signing, I am choosing to waive or not waive the criteria or confirm that my student does not have a IEP/504/EL designation. I acknowledge that if I do not waive any criteria, my student will not receive an individualized review.

Date & Time Signed: 08/31/2023 09:44:53 PM [Redo Signature](#)

Lawrence Carter

Save & Continue

Waiver Supporting Documentation Section

Nëse një aplikant me plan/kualifikim IEP, 504 ose shërbime EL zgjedh të tërhiqet nga një kriter (ose notat, frekuentimi ose rezultatet PSSA/Vlerësimi alternativ), do të shfaqet ky seksion i aplikimit. Ky seksion lejon futje informacioni për procesin e shqyrtimit të individualizuar.

Këtu, aplikantët mund të ngarkojnë [shtojcën](#) e [pranimeve](#) dhe dokumentet mbështetëse për heqjen e kritereve. Për të ngarkuar një dokument, gjeni fushën e dëshiruar të ngarkimit dhe klikoni **Choose File** (Zgjidhni skedarin). Gjeni dhe zgjidhni skedarin nga kompjuteri juaj për të ngarkuar. Mund të ngarkohen disa skedarë njëherësh, nëse është e nevojshme. Pas ngarkimit të dokumenteve, klikoni **Save & Continue** (Ruaj e vazhdo). Nëse keni nevojë për ndihmë për aksesin, gjetjen ose ngarkimin e dokumenteve, konsultohuni me konsulentin ose administratorin e shkollës.

Waiver Supporting Documentation 9/14

Complete the Admissions Addendum template available [here](#) for upload.

Please upload Admissions Addendum

[Choose File](#)

Accept .avi, .csv, .doc, .docx, .fav, .gif, .html, .jpeg, .jpg, .mp3, .mpg, .pdf, .png, .rtf, .txt, .wma, .xls, .xlsx, .zip

Please upload other supporting documents for criteria waiver

[Choose File](#)

Accept .avi, .csv, .doc, .docx, .fav, .gif, .html, .jpeg, .jpg, .mp3, .mpg, .pdf, .png, .rtf, .txt, .wma, .xls, .xlsx, .zip

Save & Continue

Seksioni i akomodimeve të posaçme arsimore

Nxënësit me IEP aktuale që janë tërhequr nga një kriter në aplikimin e tyre mund të ngarkojnë dokumentacionin mbështetës të arsimit të posaçëm në këtë seksion të aplikimit.

Në këtë seksion të aplikimit kërkohen të ngarkohen tri lloje të ndryshme dokumentesh. Këto dokumente përfshijnë:

1. dokumentacionin aktual IEP i nxënësit, 2. raporti e tyre të monitorimit të ecurisë 2022–2023 dhe
3. vlerësimin e tyre aktual transitor.

Për të ngarkuar një dokument, gjeni fushën e dëshiruar të ngarkimit dhe klikoni **Choose File** (Zgjidhni skedarin). Gjeni dhe zgjidhni skedarin nga kompjuteri juaj për të ngarkuar. Mund të ngarkohen disa skedarë njëherësh, nëse është e nevojshme. Pas ngarkimit të dokumenteve, klikoni **Save & Continue** (Ruaj e vazhdo).

Special Education Accommodations

10/14

Upload supporting documentation for the student's education accommodations below.

- If your student's school-based team will assist with uploading your student's supporting documentation you can continue with the application and follow up with the student's school for updates on these files.
- If your student's school-based team will NOT assist with uploading your student's supporting documentation, you can upload below.

Please upload current IEP documentation

[Choose File](#)

Accept .avi, .csv, .doc, .docx, .fav, .gif, .html, .jpeg, .jpg, .mp3, .mpg, .pdf, .png, .rtf, .txt, .wma, .xls, .xlsx, .zip

Please upload 2022-2023 Progress Monitoring Report

[Choose File](#)

Accept .avi, .csv, .doc, .docx, .fav, .gif, .html, .jpeg, .jpg, .mp3, .mpg, .pdf, .png, .rtf, .txt, .wma, .xls, .xlsx, .zip

Transition Assessment (Career Inventory): Transition assessments involve the continual collection of information about a student's strengths, needs, preferences, and interests.

Please upload current Transition Assessment (Career Inventory)

[Choose File](#)

Accept .avi, .csv, .doc, .docx, .fav, .gif, .html, .jpeg, .jpg, .mp3, .mpg, .pdf, .png, .rtf, .txt, .wma, .xls, .xlsx, .zip
High School Only

504 - Seksioni i akomodimeve arsimore

Nxënësit me plan aktual 504 ose që janë të kualifikuar për 504 dhe që janë tërhequr nga një kriter në aplikimin e tyre mund të ngarkojnë dokumentacionin mbështetës të arsimit të posaçëm në këtë seksion të aplikimit.

Ky seksion përfshin vetëm një fushë ngarkimi, për planin aktual/raportin e përshtatshmërisë 504 me dokumentacion mjekësor mbështetës. Për të ngarkuar një dokument, gjeni fushën e ngarkimit dhe klikoni **Choose File** (Zgjidhni skedarin). Gjeni dhe zgjidhni skedarin nga kompjuteri juaj për të ngarkuar. Mund të ngarkohen disa skedarë njëherësh, nëse është e nevojshme. Pas ngarkimit të dokumenteve, klikoni **Save & Continue** (Ruaj e vazhdo).

504 Education Accommodations

11/14

Upload supporting documentation for the student's education accommodations below.

- If your student's school-based team will assist with uploading your student's supporting documentation you can continue with the application and follow up with the student's school for updates on these files.
- If your student's school-based team will NOT assist with uploading your student's supporting documentation, you can upload below.

Please upload 504 plan with supporting medical documentation


[Choose File](#)

Accept .avi, .csv, .doc, .docx, .fav, .gif, .html, .jpeg, .jpg, .mp3, .mpg, .pdf, .png, .rtf, .txt, .wma, .xls, .xlsx, .zip

Seksioni i akomodimeve arsimore EL

Nxënësit që aktualisht marrin shërbime EL dhe që janë tërhequr nga një kriter në aplikimin e tyre mund të ngarkojnë dokumentacionin mbështetës të arsimit të posaçëm në këtë seksion të aplikimit.

Seksioni përfshin vetëm një fushë ngarkimi, për rezultatet aktuale të testit EL Access/WIDA. Për të ngarkuar një dokument, gjeni fushën e ngarkimit dhe klikoni **Choose File** (Zgjidhni skedarin). Gjeni dhe zgjidhni skedarin nga kompjuteri juaj për të ngarkuar. Mund të ngarkohen disa skedarë njëherësh, nëse është e nevojshme. Pas ngarkimit të dokumenteve, klikoni **Save & Continue** (Ruaj e vazhdo).



The screenshot shows a section titled "EL Education Accommodations" with a progress indicator "12/14". It instructs users to upload supporting documentation for the student's education accommodations. Two bullet points provide instructions: if the school-based team will assist with uploading, users can continue with the application; if not, users can upload the documentation themselves. Below this is a prompt to "Please upload EL Access/WIDA Test Score Report" and a "Choose File" button. A small text at the bottom lists accepted file formats: .avi, .csv, .doc, .docx, .fav, .gif, .html, .jpeg, .jpg, .mp3, .mpg, .pdf, .png, .rtf, .txt, .wma, .xls, .xlsx, .zip.

Hapat shtesë gjatë fazës së aplikimit

Aplikantët duhet të kujtojnë të plotësojnë seksionet e mbetura të aplikimit dhe të **dorëzojnë aplikimin e tyre përpara afatit të fundit të orës 23:59 më 27 tetor 2023**.


Pasi ky informacion të dorëzohet si pjesë e aplikimit, aplikanti do të konsiderohet se do të marrë një shqyrtim të individualizuar për çdo shkollë ku nuk plotësonte kriteret, **me kusht që nxënësi të mos kualifikohet për ASNJË shkollë apo program me bazë kriteresh të përfshira në aplikimin vet.**

Komunikimi i kualifikimit të shqyrtimit të individualizuar

Në nëntor, aplikantët dhe familjet e tyre do të marrin një përditësim në lidhje me statusin e pranimit të shortit për secilën shkollë/program për të cilin kanë aplikuar. **Kjo do të përfshijë nxënësit, aplikimet e të cilëve mund të kalojnë tek ekipi i shqyrtimit të individualizuar për shqyrtim shtesë.**

Statuset e aplikimit që mund të shfaqen për një nxënësi përfshijnë:

- *Aplikanti nuk plotësoi një ose më shumë nga kriteret - nëse nuk jeni të sigurt se cilat prej tyre, kontrolloni me konsulentin tuaj ose faqen e internetit këtu.*
- **Në pritje të shqyrtimit të kriterëve shtesë (tregon që një nxënësi është i përshtatshëm për një shqyrtim të individualizuar)** ● *Dorëzuar dhe i kualifikuar.*



The screenshot shows a table titled "Diseree's Applications" with a "Lottery Application" section. It lists three schools and their application statuses:

School	Status
Central High School	● Applicant did not meet one or more of the criteria - If you are unsure of which one(s), please check with your Counselor or the website here .
Lincoln, Abraham High School - Marketing and Entrepreneurship	● Submitted & Eligible
Washington, George High School - International Baccalaureate	● Pending Additional Criteria Review

Shënim: Statusi i *shqyrtimit të kriterëve shtesë në pritje* përdoret gjithashtu për nxënësit që kanë përmbushur të drejtën për performancën dhe shkolla me bazë projekti, dhe po kalojnë në fazën e audicionit/prezantimit të projektit të vlerësimit. **NUK është vetëm për nxënësit e shqyrtimit të individualizuar.**

Çfarë bën ekipi i shqyrtimit të individualizuar?

Shqyrtimet e individualizuara zhvillohen në nëntor dhe dhjetor, përpara shortit. Ekipi i shqyrtimit të individualizuar shqyrton aplikimin dhe dokumentacionin mbështetës për nxënësit e kualifikuar.

Ekipi i shqyrtimit të individualizuar përbëhet nga stafi i zyrës qendrore nga zyra e nxënësve diversë, zyra e kurrikulës dhe programeve shumëgjuhëshe dhe zyra e parandalimit dhe e ndërhyrjes, si dhe stafi nga shkollat me bazë kriteresh. Këta anëtarë të ekipit janë të specializuar në analizimin e dokumentacionit mbështetës dhe të të dhënave akademike, dhe do të shqyrtojnë aplikimet PARA shortit. Dokumentacioni i ofruar nga aplikantët ndihmon ekipin e shqyrtimit të përcaktojë nëse një shkollë mund të ofrojë mbështetje të arsyeshme për çdo nxënës që kërkon të ndjekë një shkollë me bazë kriteresh.

Rezultatet e shqyrtimit të individualizuar

Në janar, përpara publikimit të rezultateve të shortit, nxënësit dhe familjet do të marrin komunikim në lidhje me rezultatin e shqyrtimit të individualizuar të nxënësve të tyre.

Çdo nxënës që mendohet se ka të drejtë për një short shkollor ose program me bazë kriteresh si rezultat i procesit të shqyrtimit të individualizuar do të futet në shortin për atë shkollë/program. Ata do të mund t'i shikojnë rezultatet e lotarisë kur të gjitha rezultatet të publikohen më vonë në janar.

Procesi i shqyrtimit të individualizuar konsiderohet apelim. Pasi të jepen rezultatet përfundimtare të një shqyrtimi të individualizuar, nuk do të ketë opsione të mëtejshme apelimi në dispozicion të aplikantëve apo të familjeve.